

Rifatit ia dolën që të arratiseshin me vrap. Nuk ditën asgjë për fatin e Rifatit deri te dita e nesërme, kur në mëngjes, nga ora 6:00, shkuan në vendin e ngjarjes. Atje, e gjetën trupin e Rifatit. E kishin qëlluar me një plumb në stomak. Në afërsi të tij e kishin gjetur edhe trupin e Hazir Avdylit. Po atë ditë, Rifati u varros në *Mëhallën Shishman* në Dobroshec/Dobroševac.

Burimet: deklarata N.F, FDH-17188; deklarata M.A, FDH-17187.

Lec (Bislim) Leci

(27.05.1954, shqiptar nga Gradica/Gradica, komuna e Gllgocit/Glogovac, mjek, pjesëtar i UÇK-së)

Leci ka qenë mjek në Gllgoc/Glogovac, ndërkaq me familje jetonte në Gradicë/Gradica. Ai me bashkëshorten Eminen i kishin katër fëmijë. Aderoi në UÇK pas vrasjes së vëllezërve Ahmeti në Likoshan/Likošane, në fund të shkurtit të vitit 1998 [të shikohet regjistrimi]. I shëronte pjesëtarët e UÇK-së në shtëpinë e vet. I ndihmonte bashkëshortja, e cila ishte infermiere. Në datën 23.09.1998, kur forcat serbe e nisën ofensivën kundër UÇK-së, banorët e braktisën Gradicën/Gradica dhe u strehuan në pyllin përmbi fshatin e tyre, në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*. Leci edhe në mal vazhdoi tu ofronte kujdesin shëndetësor civilëve dhe pjesëtarëve të plagosur të UÇK-së. Dy ditë më vonë, më **24.09.1998**, përderisa vazhdonte sulmi i forcave serbe, babai i Lecit, së bashku me mbesat e tij, u tërhoqën në thellësi të pyllit, ndërkaq bashkëshortja e Lecit, me fëmijë të tjerë dhe me vjehrrën, shkoi në xhaminë e fshatit Reznik/Resnik. Leci me të vëllain dhe disa bashkëluftëtarë të tij kanë rënë në pritë të forcave serbe [**Gradicë/Gradica**]. Më këtë rast, Leci gjeti vdekjen. Një ditë më vonë, i ati Bislimi, i vëllai Rexhepi dhe motrat Naxhija dhe Fetija u nisën për ta kërkuar atë. E gjetën trupin e tij të pajetë në pyll. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e Gradicës/Gradica. Pas përfundimit të luftës, më 22.08.1999, mbetjet mortore të Lecit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance [Skënderaj/Srbica].

Burimet: deklarata A.L, FDH-31851;

SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 199-202; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ujup (Feriz) Bardiqi

(18.02.1967, shqiptar nga Gradica, komuna e Gllgocit/Glogovac)

Ujupi ka qenë i sëmure që nga fëmijëria. Nuk ishte i aftë për punë. Jetonte në bashkësi familjare me prindërit, vëllain dhe motrën në fshatin Gradicë/Gradica, përderisa motrat e tjera i kishte të martuara ndërkaq vëllai i tretë i jetonte në Gjermani. Forcat serbe e kanë nisur bombardimin e fshatit më **24.09.1998**. Para sulmeve, vendasit i kanë hapur bunkerët pranë pyllit, në afërsi të fshatit me qëllim strehimin nga sulmet eventuale serbe. Ata u strehuan nëpër bunkerët dhe aty i kaluan tri, katër orë kur forcat serbe e zhvendosen zjarrin drejt pyllit ku gjendeshin civilët. Ujup ka mbetur në bunker [**Gradicë/Gradica**], ndërkaq familjarët e tij me vendasit u tërhoqën më thellë në pyll. Në dy ditë e ardhshme, vëllai i Ujupit nuk ka arritur që t'i afrohej fshatit për të mësuar për fatin e Ujupit. Ditën e tretë, ai me kushëririn Zenelin arritën më në fund te shtëpia por nuk e gjetën Ujupin. E zbuluan trupin e tij afro 100 metra larg bunkerit. Në trup i shiheshin shenjat e keqtrajtimit fizik, ndërkaq në stomak e kishte një plagë nga armë zjarri. Hyseni dhe Zeneli e kanë varrosur Ujupin në mbrëmjen e datës 27.09.1998 në varrezat e fshatit Gradicë/Gradica.

Burimet: deklarata H.B, FDH-40613; J. Osmani, *Krimet...*, I, 184.

Vehbi (Ejup) Hoxha

(21.2.1951, shqiptar nga Krajkova/Krajkovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, bukëpjekës, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Meriton (Sadri) Elshani

(22.11.1975, shqiptar nga Krajkova/Krajkovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën **25.09.1998**, rreth orës 11:00, Meritoni, Vehbiu dhe Remzi Jakupi u nisën nga **Krajkova/Krajkovo** drejt bjeshkës së **Kosmaçit/Kosmač**, ku UÇK-ja i mbante pozicione të veta. Nga ora 13:00, familjes